



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

N. _____ REP. 5875
N. _____ KOL. 1784

**PROÇESVERBAL I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË ME PËRFGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ALMOD SH.P.K. DATË 06.12.2005**

Më datë 06.12.2005, në orën 14.00, përpara meje Noteres Arjana Mallkuçi, në selinë e Studio Legale Tonucci, në adresën Rr. A. Toptani, Torre Drin, Kati i Dytë, është mbajtur Asambleja e Ortakëve të shoqërisë Almod sh.p.k. me pjesëmarrjen e

1. Zonja Valentina Pine, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 13.8.1955, nr. pasaporte 0915226, në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Ekonomisë (më poshtë, "Ministria"), ortak i cili zotëron një kuotë të barabartë me 81,83% të kapitalit themeltar të shoqërisë Almod Sh.p.k. (më poshtë "Almod" ose "Shoqëria"), në bazë të autorizimit bashkëngjitur këtij proçesverballi (shtojca 1);
2. Av. Erinda Ballanca, lindur dhe banuese në Tiranë, Shqipëri, më 29.10.1973, dhe Av. Klotilda Ferhati, lindur në Tiranë, Shqipëri më 11.4.1979, nr. pasaporte 0245131, në cilësinë e përfaqësueseve të Shoqërisë të së drejtës italiane Simod S.p.A., ortak i cili zotëron një kuotë të barabartë me 18,17% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, në bazë të prokurës së bashkëngjitur këtij proçesverballi (shtojca 2).

Gjithashtu është i pranishëm në cilësinë e të ftuarit edhe administratori i shoqërisë Z. Avni Golaj.

Merr përsipër drejtimin e Asamblesë Znj. Valentina Pine, dhe cakton sekretare Av. Klotilda Ferhati. Kryetarja deklaron se Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë është mbledhur rregullisht për të diskutuar dhe vendosur për sa më poshtë vijon

rendi i ditës

1. Dhënia me qira e ambjenteve dhe makinerive të Shoqërisë, kërkuar nga shoqëria Ereci sh.p.k.;
2. Prishja e Shoqërisë që rrjedh nga përfundimi i afatit të përcaktuar në nenin 4 të Statutit të Shoqërisë;
3. Shpalljen e Shoqërisë në likuidim dhe emërimin e likuidatorëve;

Pasi u konstatua

Prania e ortakëve që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e Shoqërisë, Kryetarja

deklaron

Asamblenë e mbledhur në mënyrë të vlefshme dhe në gjendje për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës.

Handwritten signature

Handwritten initials: Kf and mg

* * *

1. Dhënia me qira e ambjenteve dhe makinerive të Shoqërisë, kërkuar nga shoqëria Ereci sh.p.k.

Kryetarja e Asamblesë në cilësinë e përfaqësuesit të Ortakut shtetëror propozon që mjediset e katit të dytë të godinës ku kryen aktivitetin e saj Shoqëria dhe disa makineri ti jepen me qira shoqërisë së të drejtës shqiptare ERECI sh.p.k., meqë kjo e fundit ka shprehur interesin për qiramarrjen e ambjenteve dhe makinerive si më sipër. Më tej ajo shton se meqënëse Shoqëria ka borxhe të shumta ndaj punonjësve për sa i takon pagave të vitit të fundit dhe ndaj organeve tatimore e atyre të sigurimeve shoqerore, etj.. dhe meqe nuk ka likuiditete për ti shlyer këto borxhe është në interesin e Shoqërisë të japë me qira këto ambjente (ku tashme që nga viti 1999 nuk ushtrohet më veprimtari nga Shoqëria) për të mundësuar krijimin e disa të ardhurave nga Shoqëri.

Përfaqësuesit e Simod shtrojnë pyetjet:

- saktësisht cilat ambjente dhe makineri mendohet te jepen me qira?
- për sa kohe do te vazhdoje ne fuqi kontrata e qirase?
- sa eshte cmimi i qirase?
- a ekziston ndonje draft kontrate qiraje e pergatitur?

Përfaqësuesja e ortakut shtetëror sqaron se me qira do të jepen mjediset e katit te dyte me nje siperfaqe prej 609 m2 dhe disa makineri per prodhimin e faqeve te kepuceve. Afati i qirasë do të jetë deri në përfundim të procesit të likuidimit të Shoqërisë. Cmimi i qirasë përcaktohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave n. 315 dated 24.04.2003 *Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore*. Në bazë të këtij vendimi qiraja për ndërtesën është 150 Lek për metër katror, ndërsa qiraja vjetore për makineritë llogaritet në bazë të vlerës së tyre të amortizimit pjestuar me 10. Kontrata e qirasë është një formë standarte që zbatohet nga Ministria e Ekonomisë në këto raste qiradhënieje. Kjo kontratë do të lidhet midis shoqërisë Ereci sh.p.k. dhe Almod.

Përfaqësueset e ortakut shtetëror, parashtrojnë se:

1. Vendimi I Këshillit të Ministrave nuk është I detyrueshëm për Shoqërinë përderisa kjo e fundit nuk zotërohet 100 % prej shtetit shqiptar dhe duke patur parasysh a) gjendjen e rënduar debitore që ka Almod; b) faktin që qiratë e aplikuara në treg janë më të larta se vlera e paraqitur prej përfaqësuesit të ortakut shtetëror; c) me qëllim që të mundësohet që nga të ardhurat e kontratës së qirasë me shoqërinë Ereci sh.p.k., Almod të paguajë disa borxhe, propozojnë që cmimi I qirasë të rritet të paktën deri në 3 (tre) Euro për m2. Gjithashtu, përfaqësueset e Simod shtrojnë se vendimi I Këshillit të Ministrave më sipër përcakton cmimin dysheme të qirasë, që do të thotë se nuk mund të vendoset një cmim qiraje më I ulët se ai I përcaktuar aty dhe nuk ndalon përcaktimin e një cmimi më të lartë. Gjithsesi, kjo duhet analizuar edhe në përputhje me interesin e shprehur nga ana e shoqërisë ERECI sh.p.k.

Q

KF

EFB

2. Duke patur parasysh që Simod është kreditor ndaj shoqërisë Almod në shumën prej 482. 999, 012 Euro, shumë kjo që rrjedh nga furnizimi me makineri kryer nga Simod shoqërisë Almod nga viti 1993 e deri në vitin 1996. (Kjo kredi e Simod ndaj Almod është njohur prej Almod në Protokollin e 4-5 qershorit 1996 nënshkruar nga Almod sh.p.k dhe nga ortaku Simod; në shoqëri ekzistojnë të të gjitha faturat që provojnë këtë kredi të Simod), me qëllim fillimin e shlyerjes së kësaj kredie përfaqësueset e Simod, propozojnë që pagesat nga kontrata e qirasë me shoqërinë ERECI sh.p.k. të paguhen drejtpërsëdrejti tek Simod.

Në lidhje me pikën e parë ngritur nga përfaqësueset e Simod, Znj. Pine sqaron se udhëzimi I Ministrisë të Ekonomisë është që cmimi I qirasë të caktohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave si më sipër, ndërsa në lidhje me pikën e dytë thekson se të ardhurat nga kontrata e qirasë me shoqërinë ERECI duhet të përdoren fillimisht për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë ndaj punëtorëve të saj që janë emergjente dhe për këtë arsye këto të ardhura I duhen paguar drejtpërsëdrejti shoqërisë.

Në përfundim të diskutimeve Asambleja me shumice votash,

Vendosi

- Të miratojë dhënien me qira të mjediseve të katit të dytë (sip. 609 metër katror) dhe disa makinerive të Almod, shoqërisë ERECI sh.p.k.;
- Cmimi I qirasë të përcaktohet në përputhje me VKM n. 315 datë 24.04.2004;
- Kohëzgjatja e kontratës së qirasë të jetë deri në përfundim të procesit të likuidimit të shoqërisë;
- Pagesat e qirasë do të kryhen nga qiramarrësi në llogaritë bankare të Shoqërisë.

2. Prishja e Shoqërisë që rrjedh nga përfundimi i afatit të përcaktuar në nenin 4 të Statutit të Shoqërisë

Kryetarja e Asamblesë në cilësinë e përfaqësuesit të ortakut shtetëror sqaron se duke patur parasysh se afati I shoqërisë në bazë të nenit 4 të Statutit të saj, ka mbaruar Shoqëria duhet të priset dhe të kalojë në likuidim.

Përfaqësueset e Simod sugjerojnë se përpara se të merret vendimi për të prishur Shoqërinë dhe për të kaluar atë në likuidim, do të ishte shumë e rëndësishme të kryhej një vlerësim ekonomik financiar dhe I aseteve të shoqërisë. Ky vlerësim do të ndihmonte ortakët të analizonin nëse shoqëria duhej të vazhdojë veprimtarinë e saj apo të priset e më pas të kalojë në likuidim. Prandaj sugjerojnë që të shtyhet vendimi për prishjen e shoqërisë deri në përfundimin e një raporti vlerësimi si më sipër.

Zn. Pine sqaron se ky sugjerim I Simod nuk mund të pranohet, pasi situata financiare dhe ekonomike e Almod është qartësisht shumë e keqe dhe nuk është e nevojshme të kryhet ndonjë vlerësim I mëtejshëm; dhe më pas fiton palët të vendosin në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Në përfundim Asambleja,

LF EFB

Vendosi

- Prishjen e Shoqërisë si rezultat I përfundimit të afatit të saj dhe kalimin e saj në likuidim.

Më tej, Znj. Pine fton ortakun SIMOD të propozojë një prej likuidatorëve të Shoqërisë. Përfaqësuesi I Simod propozon ekspertin kontabël Z. Artan Golemi për tu emëruar si likuidator I Shoqërisë dhe nga lista e ekspertëve kontabël të paraqitur nga Znj.Pine sugjeron të zgjidhet në detyrën e likuidatorit edhe Znj. Mimoza Sula.

Në vijim, Asambleja

Vendosi

- Emërimin e Z. Artan Golemi dhe Znj. Mimoza Sula, ekspertë kontabël të autorizuar në cilësinë e likuidatorëve të Shoqërisë.
- Kohëzgjatja e mandatit të tyre do të jetë në përputhje me Ligjin 7638 datë 19.11.1992 *Për shoqëritë Tregtare;*
- Shpërblimi për likuidatorët do të vendoset me vendim të ortakëve pas rregjistrimit në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë, të vendimit të Asamblesë së Shoqërisë për emërimin e tyre si likuidatorë të Almod;
- Fondet për shpërblimin e likuidatorëve do të sigurohen nga shitja e aseteve të Shoqërisë, në përputhje me raportin e likuidimit.

Me tej, e marrin fjalën përfaqësuesit e Simod që sqarojnë se në asambletë e mëparshme i është lënë detyrë administratorit të Shoqërisë që përpara se të miratohet nga Asambleja e ortakëve bilanci i vitit 2003, ky bilanc të kontrollohet nga një ekspert kontabël i autorizuar dhe në të të përfshihet (nëse nuk rezulton) kredia që ortaku Simod ka ndaj shoqërisë në vlerën prej 482 999, 012 Euro. Sic u shpjegua me sipër kjo shumë rrjedh nga furnizimi me makineri kryer prej Simod për llogari të Almod nga viti 1993 e deri në vitin 1996. Në shoqëri ekzistojnë të gjitha faturat që provojnë furnizimet e makinerive si më sipër dhe materiale të tjera që provojnë këtë kredi të Simod ndaj Almod. Kjo çështje i është bërë e njohur përfaqësuesit të ortakut shtetëror vazhdimisht në asambletë e mëparshme të shoqërisë.

Gjithashtu, përfaqësuesit e Simod kërkojnë që ekspertët kontabël që do të kontrollojnë bilancet e Shoqërisë të verifikojnë nëse kredia e institucionit italian SACE (Servizi Sicurativi del Commercio Estero) që rrjedh nga garancia që ky institucion i ka bërë furnizimeve të makinerive prej Simod tek Almod është përfshirë në këto bilance.

Pas diskutimeve në lidhje me këtë pike Asambleja,

Vendosi

[Handwritten signature]


KF

EF 15


- të ngarkojë likuidatorët e shoqërisë për të kontrolluar bilancet e shoqërisë për vitin 2003, 2004, dhe 2005 dhe të përfshihet në ta kredia që pretendon Simod ndaj Almod, nëse kjo kredi rezulton nga dokumentacioni përkatës;
- të ngarkojë likuidatorët të verifikojnë nëse kredia e SACE si më sipër është inkluduar në bilancin e Almod;

Duke mos pasur asgjë tjetër për të vendosur dhe meqënëse rendi i ditës nuk ka më pika për të diskutuar dhe vendosur, Kryetarja deklaron të mbyllur Asamblenë në orën 17.00.

Kryetare
Znj. Valentina Pine



Sekretare
Z. Klotilda Ferhati



Ortakët

SIMOD
Perfaqesuar nga:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes
Perfaqesuar nga:

Av. Erinda Ballanca


Znj. Vali Pine




Av. Klotilda Ferhati



Notere



NOTERE
R. MALLKUSI
Tëllzgj. 050253 76242



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
N⁶⁹⁸²REP.
N²⁴⁷KOL.



PROÇESVERBAL I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ALMOD SH.P.K. DATË 19.10.2006

Më datë 19.10.2006, në orën 11.00, përpara meje Noteres Arjana Mallkuçi, në selinë e Studio Legale Tonucci, në adresën Rr. A. Toptani, Torre Drin, Kati i Dytë, është mbajtur Asambleja e Ortakëve të shoqërisë Almod sh.p.k. me pjesmarrjen e:

1. **Znj. Valentina Pine**, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 13.8.1955, nr. pasaporte 0915226, në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Ekonomisë (më poshtë, "Ministria"), ortak i cili zotëron një kuotë të barabartë me 81,83% të kapitalit themeltar të shoqërisë Almod Sh.p.k. (më poshtë "Almod" ose "Shoqëria"), në bazë të autorizimit bashkëngjitur këtij procesverballi (shtojca 1);
 2. **Av. Klotilda Ferhati**, lindur në Tiranë, Shqipëri më 11.4.1979, nr. pasaporte 0245131, në cilësinë e përfaqësueseve të Shoqërisë të së drejtës italiane Simod S.p.A., ortak i cili zotëron një kuotë të barabartë me 18,17% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, në bazë të prokurës së bashkëngjitur këtij procesverballi (shtojca 2).
- Gjithashtu është i pranishëm në cilësinë e të ftuarit edhe administratori i shoqërisë Z. Avni Golaj dhe Z. Servet Borici.

Merr përsipër drejtimin e Asamblesë Znj. Valentina Pine, dhe cakton sekretare Av. Klotilda Ferhati. Kryetarja deklaron se Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë është mbledhur rregullisht për të diskutuar dhe vendosur për sa më poshtë vijon:

Rendi i Ditës

1. Ndryshimin e likujdatoreve të shoqërisë Almod sh.p.k. emeruar në asamblye të ortakëve date 06.12.2005;

Pasi u konstatua

Prania e ortakëve që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e Shoqërisë, Kryetarja

deklaron

Asamblyenë e mbledhur në mënyrë të vlefshme dhe në gjendje për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës.

1. Ndryshimi i likujdatoreve te shoqerise Almod sh.p.k. emeruar ne asamblene e ortakeve date 06.12.2005

Kryetarija e Asamblesë në cilësinë e përfaqësuesit të Ortakut shtetëror propozon që likujdatorët e shoqerise te emeruar ne asamblene e dates 06.12.2005 te shkarkohen dhe ne vend te tyre te emerohet ne cilesine e likujdatorit te ri Z. Servet Borici, lindur me date 23.12.1962 ne Diber, dhe banues ne Shkozet, Durres.

Perfaqesuesja e ortakut Simod s.p.a kerkon qe pervec zotit Servet Borici te propozuar nga ortaku shteteror ne detyren e likujdatorit te ri te shoqerise, te emerohet ne kete detyre edhe nje likujdator tjetër i propozuar nga ortakut Simod s.p.a. Ne kete menyre do te kemi nje kontroll te drejte te shoqerise prej dy likujdatoreve te emeruar nga ortakët dhe te propozuar prej secilit ortak.

Znj. Valentina Pine sqaron se ne lidhje me kete ceshtje ajo nuk mund te shprehet pasi tagrat e perfaqesimit te saj ne kete asamble jane te percaktuara vetem per sa parashikohet shprehimisht ne rendin e dites, por sqaron se per kete ceshtje do te konsultohet me eproret perkates dhe do te jete objekt diskutimi ne nje asamble te ardhshme te ortakeve te shoqerise.

Me tej, Perfaqesuesja e ortakut Simod s.p.a. kerkon informacione mbi punen e deritanishme te likujdatoreve te emeruar nga asambleja e ortakeve te shoqerise date 06.12.2005.

Likujdatorët e shoqerise te emeruar me vendimin e asamblese date 06.12.2005 nuk jane te pranishem ne kete mbledhje prandaj keto informacione nuk mund te merren gjate kesaj mbledhjeje.

Perfaqesuesja e ortakut Simod sqaron se likujdatori i ri i shoqerise, nese do te revokohen likujdatorët e shoqerise te emeruar ne asamblene e ortakeve date 06.12.2005, duhet te kete te njejtat detyra me ta dhe vecanerisht ato detyra qe iu caktuan likujdatoreve ne asamblene e ortakeve date 06.12.2005.

Sqarojme se në asamblene e ortakeve date 06.12.2005 i është lënë vecanerisht detyrë likujdatoreve:

1. për të kontrolluar bilancet e shoqërisë për vitin 2003, 2004, dhe 2005 dhe të përfshihet në ta kredia që pretendon Simod ndaj Almod, nëse kjo kredi rezulton nga dokumentacioni përkatës;
2. të verifikojnë nëse kredia e SACE është inkluduar në bilancin e Almod;

Ne lidhje me piken 1) me siper theksojme se behet fjale per shumen prej 482. 999, 012 Euro per te cilen Simod është kreditor ndaj shoqërisë Almod. Kjo shumë sic eshte qartesuar ne asamblete e meparshme te ortakeve rrjedh nga furnizimi me makineri qe Simod ka kryer ne favor te shoqërisë Almod sh.p.k. nga viti 1993 e deri në vitin 1996. Kjo kredi e Simod s.p.a.ndaj Almod është njohur prej Almod sh.p.k. në Protokollin e



4-5 qershorit 1996 nënshkruar nga Almod sh.p.k dhe nga ortaku Simod s.p.a.; në shoqëri (Almod sh.p.k.) ekzistojnë të gjitha faturat që provojnë këtë kredi të Simod s.p.a. ndaj Almod sh.p.k. dhe gjithashtu ortaku Simod s.p.a. disponon të gjithë materialin justifikues për këtë kredi të tij ndaj Almod sh.p.k. Likujdatoreve të emeruar në asamblene date 6.12.2005 u është ngarkuar si detyrë për të kontrolluar bilancet e shoqërisë për vitin 2003, 2004, dhe 2005 dhe të përfshihet në ta kredia që pretendon Simod s.p.a. ndaj Almod, sic rezulton nga dokumentacioni përkatës.

Ne lidhje me piken 2) me sipër sqarojmë se bëhet fjalë për kredinë e institucionit italian SACE (Servizi Sicurativi del Commercio Estero) që rrjedh nga garancia që ky institucion i ka bërë furnizimeve të makinerive prej Simod tek Almod, dhe likujdatoreve të emeruar në asamblene e ortakeve date 06.12.2005, u është ngarkuar si detyrë të verifikojnë nëse në bilancet e Almod është përfshirë kjo kredi i SACE.

Në vijim të diskutimeve, Asambleja


Vendosi

- Shkarkimin nga detyra e likujdatoreve të shoqërisë Z. Artan Golemi dhe Znj. Mimoza Sula të emeruar në këtë detyrë në asamblene e ortakeve date 06.12.2005;
- Emërimin e **Z. Servet Borici**, lindur me 23.12.1962, në Diber, banues në Shkozë të Durrës, në cilësinë e likujdatorit të ri të Shoqërisë;
- Kohëzgjatja e mandatit të Z. Servet Borici në detyrën e likujdatorit do të jetë në përputhje me Ligjin 7638 datë 19.11.1992 *Për shoqëritë Tregtare*;
- Përveç detyrave që i ngarkohen likujdatorit sipas Statutit të Shoqërisë dhe ligjit, likujdatori do të ketë edhe detyrat që i ishin ngarkuar likujdatoreve të mëparshëm me vendimin e asamblese së ortakeve date 06.12.2005 dhe vecanerisht likujdatori ngarkohet të:
 - a) kontrollojë bilancet e shoqërisë për vitin 2003, 2004, dhe 2005 dhe të përfshihet në ta kredia që pretendon Simod ndaj Almod, nëse kjo kredi rezulton nga dokumentacioni përkatës;
 - b) të verifikojë nëse kredia e SACE si më sipër është inkluduar në bilancin e Almod sh.p.k.
- Likujdatori Z. Servet Borici të komunikojë me ish-likujdatorët Z. Golemi dhe Znj. Sula dhe të marrë në dorezim me shkrim punën e tyre të kryer deri me sot.

Me tej, e merr fjalën përfaqësueseja e Simod s.p.a që kërkon të informohet nëse është depozituar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi i asamblese date 6.12.2005. Administratori Golaj sqaron se procedura për këtë regjistrim ka nisur por ai nuk ka dijeni nëse ky regjistrim është kryer, pasi këtë procedurë e kanë ndjekur likujdatorët e shoqërisë.

Në vijim të diskutimeve, Asambleja

Vendosi:




- Te ngarkoje **Z. Servet Borici**, lindur me 23.12.1962, ne Diber, banues ne Shkozet Durres, në cilësinë e likujdatorit të Shoqërisë të emeruar ne Asamblene e ortakeve date 19.10.2006 te depozitoje vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise Almod sh.p.k. date 19.10.2006, ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rethit Gjyqsor Tirane dhe ne organet tatimore perkatese dhe ne permbushje te ketij qellimi ai ka te drejte te nenshkruaje te gjithe aktet perkatese dhe te perfaqesoje shoqerine perpara organeve gjyqesore dhe tatimore;

Te ngarkoje **Z. Servet Borici**, lindur me 23.12.1962, ne Diber, banues ne Shkozet Durres, per te verifikuar nese eshte depozituar ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rethit Gjyqsor Tirane, vendimi i asamblese se ortakeve date 6.12.2005 dhe nese kjo procedure nuk eshte kryer ngarkohet Z. Servet Borici te depozitoje vendimin e asamblese se ortakeve te Shoqerise Almod sh.p.k. date 06.12.2005, ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rethit Gjyqsor Tirane dhe ne organet tatimore dhe ne permbushje te ketij qellimi ai ka te drejte te nenshkruaje te gjithe aktet perkatese dhe te perfaqesoje shoqerine perpara organeve gjyqesore dhe tatimore;

Duke mos pasur asgjë tjetër për të vendosur dhe meqënëse rendi i ditës nuk ka më pika për të diskutuar dhe vendosur, Kryetarja deklaron të mbyllur Asamblenë në orën 14.00.

Kryetare
Znj. Valentina Pine



Sekretare
Z. Klotilda Ferhati



Ortaket

SIMOD
Perfaqesuar nga:


Av. Klotilda Ferhati

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes
Perfaqesuar nga:

Znj. Vali Pine

